



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:025405

Datë: 03.04.2019

Numri i dokumentit: 00266548

P. nr.414/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i përgjithshëm penal, gjyqtarja **Iirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në lëndën penale kundër të akuzuarit P.Z. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të pa ligjshëm nga neni 300 /2 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP/II.nr.1793/16 datës 08.06.2018, gjatë shqyrtimit gjyqësor më datë **28.03.2019**, në prezencën e përfaqësuesit të Prokurorisë - Prokurorit Mone Syla ,mbrojtësit të akuzuarit av. I.D. si dhe të akuzuarit P.Z. , mori dhe të njëjtën ditë publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **P.Z.** nga Gjakovë, Rr “... “ data e lindjes ... , biri i I. dhe i nënës A. e gjinisë H. ,ka të kryer shkollën fillore , i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punë ,i martuar atë i 1 fëmijëve, shqiptar , shtetar i Republikës së Kosovës , me ID ...

Bazuar në nenin 363 par. 1 pika 1.1 të KPPK-së:

REFUZOHET AKUZA

Se:

- në periudhën kohore të pavërtetuar e gjere me dt. 26.08.20158 , ne Gjakovë ne lokalit ne rrugën “...” , me qëllim të përfitimit pasuror të kundërligjshëm e ne kundërshtim me Ligjin mbi Lojrat e Fatit , ka organizuar lojë të faktit në atë mënyrë që ne lokal ka vendosur 5 aparate “KAJOT ADMIRAL ACTI APEX” dhe 3 aparate të llojit “ADMIRAL” pa numër serik dhe pas kontrollimit dhe verifikimit të aparateve në fjalë me dt. 26.08.2015, nga ana e policisë ,inspektorëve tatimor dhe hetuesve doganor ka rezultuar se kjo veprimtari është pa licencë , pa leje apo koncesion të organit kompetent , me ç’rast 5 aparatet e llojit “KAJOT “ dhe 3 aparatet e llojit “ADMIRAL” janë sekuestruar nga ana e hetuesve doganor.

-me çka do të kishte kryer veprën penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300/2 të KPRK-ës

Shpenzimet e procedurës penale, bien në barrën e mjeteve buxhetore të Gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore DP në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.1793/16 të datës 08.06.2018, ka akuzuar të akuzuarin P.Z. nga Gjakova, për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300/2 të KPRK-ës .

Prokurori i shtetit Mone Sylja gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt. 19.12.2018 lexoi aktakuzën PP/II 1793/16 të dt. 08.06.2018 , deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës .

I akuzuari P.Z. gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt. 19.12.2018 lidhur me fajësinë ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për këtë veprë për të cilën akuzohet me qene se pronari i kësaj firme ka qene E. K. nga Juniku për çka edhe në shkresat të lëndës kam prezantuar si prova certifikatën e regjistrimit të biznesit ,dt.25.11.2010, në emër të personit fizik E. K. , po ashtu lejen e punës të lëshuar nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomike dt. 05.04.2011,po ashtu Aktvendimin e Drejtorisë së Inspektoratit dt. 04.04.2011,me të cilën lejohet E. K. si titullar i firmës SHPK “...” shfrytëzimi i lokalit në rrugën “...” në Gjakovë , për kryerje të veprimtarisë , e në të cilën lokal me rastin e kontrollit dhe verifikimit nga organet kompetente ditën kritike kam hasur unë vetëm si punëtor .Andaj propozoi që në cilësi të dëshmitarëve të ftohte pronari E. K. nga Juniku si dhe i biri K. K. i cili ditën kritike ka qene prezent duke deklaruar se heq dorë nga mbajtja e shqyrtimit të dytë në mënyrë që të vazhdohet me shqyrtimin gjyqësor .

Prokurori i shtetit Mone Sylja, gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt. 28.03.2019 deklaroi se në këtë fazë të procedurës pas dëgjimit këtu dëshmitarit K. K. ku i njëjti ka pranuar se që nga muaji 01.08.2015 ka marrë qira lokal në rrugën “...” në Gjakovë ,për të ushtruar veprimtarinë e lojërave të fatit ,ku në atë lokal kanë që të vendosura 5 aparatet të llojit “KAJOT ADMIRAL ACTI APEX” dhe 3 aparate të llojit “ADMIRAL” dhe se i njëjti ka qene prezent ditën kritike me rastin e kontrollit nga organet kompetente , në mungesë të mjetit të identifikimit është iniciuar kallëzimi penal në emër të P.Z.t ,rezulton se P.Z. ka qene vetëm punëtor i tij të cilën e vërteton edhe vet prania e tij në dëshminë e dhënë ,andaj tërhiqem nga ndjekja penale dhe aktakuza PP/II 1793/16 nga këtu të akuzuarit P.Z. nga Gjakova me kushte që për këtë veprë penale do të ngritet aktakuze e re ndaj tani këtu dëshmitarit K. K.

Pasi që Prokurori është tërhequr nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit , Gjykata në bazë të nenit 363 par. 1 pika 1.1 të KPPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 454 par. 1 të KPPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË P nr.414/18 të dt. 28.03.19.

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej 15

Numri i lëndës: 2018:025405
Datë: 03.04.2019
Numri i dokumentit: 00266548

ditësh ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës se Apelit ne Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.